




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim


Nr-DATË/A:	07Nr.196/350-13140 datë 02.04.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350-13140 datë 24.02.2021
PËR/TO:	Vendona Zenelaj - Peqan, Komuna Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI REXHEPAJ Zyrtare e lartë për ndërtimtari: Doruntina BYTYQI ing. Dipl. Ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-13140 datë 24.02.2021 nga Vendona Zenelaj nga fshati Peqan, Komuna Suharekë, për Leje Ndërtimore për objektin e përkohshëm me destinim **Ferm për pula, me etazhitet P+0**, në parcelat kadastrale 01610-1, 01610-2, 01610-3 me numër referues të certifikatës 1155/2021 datë 04.03.2021, ZK Peqan prona të Selajdin, Mehdi dhe Muhamet Fandaj, ish parcela 01610-0 ZK Peqan të certifikatës me numër 4452/2021 datë 26.08.2020 sipas kontratës mbi dhënie me qera të tokës bujqësore Nr.LRP.3665/2020 dhe Nr. Ref. 1016/2020 datë 26.08.2020, andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 02.04.2021

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.196/350-13140

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, nenit 56 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve 01Nr-16-423 dt:26.01.2011 dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA-se, Nr.05-L-031 dhe kërkesës me dokumentacionin e paraqitura nga Vendona Zenelaj nga Peqani - Suharekë, DUP lëshon këtë:

A K T V E N D I M
LEJE NDËRTIMORE

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Vendona Zenelaj	Nr. Personal	
Adresa:	Peqan - Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore 07Nr.350-13140 datë 24.02.2021

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI (i përkohshëm)			
Adresa: Peqan - Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Peqan		Nr. i parc.kadastrale:	Përpjesa:
Sipas çertifikatës me nr. Referues: 1155/2021 datë 04.03.2021 dhe 4452/2021 datë 26.08.2020		01610-1, 01610-2, 01610-3 ish 01610-0	1:934

Lloji i ndërtimit të propozuar: Fermë për pula-objekt i përkohshëm			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara: Kategoria I			
Gabariti	18.7m' x 8.00m'	Katshmëria:	P+0, sipërfaqja bruto 150m ²
Vija rregullative	Nga aksi i rrugës 10.0m'	Vija ndërtimore	Nga aksi i rrugës 55.2m'

Përshkrimi:

Vendona Zenelaj nga Gjinoci ka kërkuar ndërtimin e objektit me destinim Fermë për pula, në parcelat katastrale 01610-1, 01610-2, 01610-3 me numër referues të çertifikatës 1155/2021 datë 04.03.2021, ZK Peqan prona të Selajdin, Mehdi dhe Muhamet Fandaj, ish parcela 01610-0 ZK Peqan të çertifikatës me numër 4452/2021 datë 26.08.2020 sipas kontratës mbi dhënien me qera të tokës bujqësore Nr.LRP.3665/2020 dhe Nr. Ref. 1016/2020 datë 26.08.2020

Lokacioni i objektit është në kuadër të PZhK 01Nr.5821 datë 05.03.08, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela është me destinim bujqësi, andaj objekti në fjalë do të ketë karakter të përkohshëm dhe do të shfrytëzohet për Fermë për pula, sipas projektit të hartuar nga byroja projektuese "POINT construction" SH.P.K. Prishtinë. Objekti do të jetë i përkohshëm, me etazhitet P+0, pa pllakë meskati nga betoni, me mbulesë nga materiali i lehtë ndërtimor me mundësi të demolimit dhe largimit sa më të lehtë. Ndërtimi i objektit të bëhet konform kushteve të caktuara nga ky organ 07Nr.47/350-5076 datë 04.02.2021.

Objekti të ndërtohen sipas standardeve dhe normat teknike - urbanistike. Objekti të këtë të vendosura filtrat të posaçëm për mbrojtje e ndotjes së ajrit jashtë tij. Deponimi i fekaleve të bëhet konform rregullave dhe dispozitave në fuqi ashtu që të mos ketë ndotje të mjedisit përreth.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e aprovimit, përveç nëse zgjatet afati.

Duhet të siguroheni se kontraktuesi i posedon në vendndërtim dokumentet e mëposhtme:

-Një kopje të kësaj leje ndërtimore.

-Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktorit.

-Së paku një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.

Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.

Libri dhe ditari i ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe fotografike, që dokumentojnë:

Datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore dhe përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.

Duhet të dorëzoni një njoftim mbi qëllimin për të filluar ndërtimin së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore pranë Drejtorisë së Inspeksionit.

Duhet të kontaktoni organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin ose inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike. Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportoj në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, lokacion ky që gjendet në vendin e quajtur Shiroka i caktuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës në bazë të Vendimit 01Nr-16-7254 të datës 30.06.2015. Pas përfundimit të punëve ndërtimore, duhet të aplikoni për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe Kodin.

Inspektor

Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit

Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit



Arsyetim

Vendona Zenelaj nga Peqan, me kërkesën 07Nr.350-13140 datë 24.02.2021 ka kërkuar leje ndërtimore nga DUP për ndërtim të objektit të përkohshëm me destinim Fermë për pula, bashkangjitur me kërkesën ka prezantuar dokumentacionin: Kopje e planit, Çertifikata e pronësisë, projekt propozimi për zgjedhje urbane të lokacionit si dhe dokumentacionin e nevojshëm që i është kërkuar si:

- a. Lejen Mjedisore Komunale 03Nr.148/181-10911 datë 01.04.2021 lëshuar nga DSHPME
- b. Vërtetim për mbeturina nr.26/21 të datë 11.02.2021, lëshuar nga NPRM "Eko-Regjioni" Prizren, Njesia Operative Therandë.
- c. Pëlqim për mbrojtje nga Zjarri Nr.03/03-11 datë 12.02.2021, lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë, Sektori i parandalimit të zjarrit.
- d. Pëlqim për kycje në komunikacion nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.494 datë 11.02.2021.
- e. Aplikimin për rregullim të dokumentacionit teknik nga KEDS nr.157 datës 16.02.2021.
- f. Pëlqim sanitaro - higjenik nga Inspektori i sanitarisë 09Nr.502 datë 11.02.2021.

Sipas alinesë 8.14.4 të nenit /8 të rregullores për tarifat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale, parashtruesi i kërkesës është liruar nga çdo pagesë (taksë) në DUP.

Ky organ përmes shërbimit të vetë profesional pas shqyrtimit të kërkesës me dokumentacionin përcjellës, pëlqimeve të siguruara nga pala në institucionet përkatëse, si dhe meqenëse kushtet aktuale ligjore (PZhK 01Nr.5821 datë 05.03.08) nuk lejonin ndërtim të përhershëm u vendos që ky objekt të jetë i përkohshëm.

Për nevoja të realizimit të planeve për zhvillime bujqësore në këtë pjesë të komunës, ky objekt largohet nga ana e investitorit pa kompensim. Për largimin e objektit lëshohet aktvendim i posaçëm.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij dokumenti.


Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje ndërtimore mund ti paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Numri i vrojtimit i lejes, 07Nr.196/350-13140 të datës:02.04.2021, Suharekë

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës,
- Dosjes së DUP-së



Drejtori i Drejtorisë
Sanie KUQI REXHEPAJ

REPUBLIKA E KOSOVES
SHIRINJA
SHIRINJA
SHIRINJA